



NEW HORIZON
Civil Society Organization



Mali i Zi
Ministria për të Drejtat
e Njeriut dhe të Pakicave



GJUHA E ADMINISTRATËS SIME

Raport monitorimi

Titulli i publikimit:
GJUHA E ADMINISTRATËS SIME



NEW HORIZON
Civil Society Organization

Botues:

OJQ „Horizonti i Ri“

Ulqin

Tel: +382 68 300 603

E-mail: horizon@t-com.me

www.ngo-horizonti.org

 newhorizonngo

Për botuesin:

Nazif Veliqi

Hulumtimin e realizuan

Admir Gjoni

Mustafa Canka

Almedina Dodiq

Nermina Çausi

Nazif Veliqi

Faqosja dhe dizajni:

Omer Muslica

Shtypi:

Trio Pro (Ulqin)

Ulqin, tetor 2019.

Publikimi i kësaj analize është pjesë e projektit „Gjuha ime – gjuhë e barabartë“ të cilin e realizon OJQ „Horizonti i Ri“ në partneritet me OJQ „UL info“. Projekti mbështetet nga Ministria për të Drejtat e Njeriut dhe të Pakicave e Malit të Zi, në kuadër të Programit për zhvillimin dhe avancimin e të drejtave të popujve pakicë dhe bashkësive tjera etnike. Përmbajtja e kësaj broshure është përgjegjësi vetëm e autorit dhe në asnjë mënyrë nuk paraqet qëndrimet e donatorit.

HYRJE

Një nga të drejtat kryesore të përfaqësuesve të popujve pakicë është përdorimi i lirë i gjuhës dhe i alfabetit të tyre. Prandaj, rëndësia e kësaj të drejte është njohur në shumë dokumente ndërkombëtare. Një nga këto dokumente është edhe **Deklarata e Kombeve të Bashkuara për Të Drejtat e Personave Pjesëtarë të Pakicave Etnike, Religjioze dhe Gjuhësore**, me të cilën, në mes tjerash, përcaktohet që pakicat kanë të drejtë të përdorin gjuhën e vet, në publik dhe privatisht, lirë dhe pa implikime nga jashtë, si dhe pa diskriminim.

Mirëpo, për këtë problematikë më të rëndësishme janë dokumentet e krijuara nga Këshilli i Evropës, respektivisht **Karta Evropiane për Gjuhët Rajonale ose të Pakicave dhe Konventa Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Nacionale**. Këto dy dokumente karakterizohen nga fakti që me ato trajtohet edhe përdorimi zyrtar i gjuhës, që është koncept më i ngushtë në krahasim me përdorimin publik të gjuhës, siç u trajtua në Deklaratën e OKB-së. Kështu në Konventën e përmendur kornizë, është paraparë që „në zonat që janë tradicionalisht të banuara ose janë në një numër të konsiderueshëm të banuara nga pjesëtarë e pakicave nacionale, në qoftë se këto pjesëtarë e kërkojnë një gjë të tillë dhe nëse kërkesa i përgjigjet nevojës reale, nënshkruesit e Konventës do të tentojnë që të sigurojnë, sa është e mundur, kushtet që gjuha e pakicave të përdoret në marrëdhëniet e këtyre pjesëtarëve me organet e administratës”. Nga ana tjetër, me Kartën Evropiane, në pjesën e masave për avancimin e përdorimit të gjuhëve rajonale ose të pakicave në jetën publike, shtetet anëtare obligohen që të mundësojnë përdorimin e gjuhëve rajonale dhe të pakicave në dorëzimin e kërkesave me shkrim dhe gojë, si dhe që administratat vendore të publikojnë dokumentet e veta zyrtare në gjuhët përkatëse rajonale dhe të pakicave.

Për të siguruar një shoqëri shumetnike, demokratike dhe pluraliste, korniza ligjore e Malit të Zi përcakton mekanizmat thelbësorë për mbrojtjen e të drejtave gjuhësore të komuniteteve dhe obligon të gjithë institucionet dhe shërbimet publike që të respektojnë përdorimin dhe statusin e barabartë të gjuhëve zyrtare.

Kështu, me **Kushtetutën e Malit të Zi** është paraparë që në përdorim zyrtar është edhe gjuha shqipe, ndërsa me **Ligjin për Administratën Shtetërore** është përcaktuar që „organet e administratës shtetërore iu sigurojnë përfaqësuesve të popujve pakicë dhe të komuniteteve tjera të pakicave nacionale, realizimin e të drejtave për të përdorur gjuhën dhe shkrimin e tyre në përdorim zyrtar, si dhe për të zhvilluar procedurën administrative edhe në gjuhën e tyre, në mjediset me pjesëmarrje të konsiderueshme në popullsi, në pajtim me ligjin”. Dispozita „pjesëmarrja e konsiderueshme në popullsi” është përcaktuar në mënyrë precize me **Ligjin për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut**, ku me Nenin 11, në mes tjerash, definohet që „në njësitë e vetëqeverisjes vendore ku përfaqësuesit e popujve pakicë dhe të komuniteteve të tjera të popujve pakicë përbëjnë shumicën ose të paktën 5% të popullsisë, sipas rezultateve të dy regjistrimeve të fundit të popullsisë, në përdorim zyrtar është edhe gjuha e këtyre popujve pakicë ose të komuniteteve të tjera pakicë”. Po ashtu, me **Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale**, „në komunitat ku shumicën ose pjesën e konsiderueshme të popullsisë e bëjnë përfaqësuesit e popujve pakicë ose të komuniteteve të tjera pakicë, plani (i mbajtjes së shqyrtimeve publike, vërejtje e autorit) përmban edhe mënyrën e sigurimit të pjesëmarrjes së popujve pakicë ose të komuniteteve të tjera pakicë edhe në gjuhën e tyre”. Këtu dëshirojmë të veçojmë se edhe **Statuti i Komunës së Ulqinit** përcakton se „në Komunën e Ulqinit janë në mënyrë të barabartë në përdorim zyrtar gjuha malazeze, respektivisht gjuha serbe me shqiptim ijekavik me alfabetin latin dhe cirilik, si dhe gjuha dhe alfabeti shqip”.

Mali i Zi po ashtu ka hartuar **Strategjinë e Politikës së Pakicave**, si dokument themelor planifikues i cili definon politikën e Qeverisë së Malit të Zi në fushën e respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave të pakicave, ku përdorimi i gjuhës dhe i alfabetit është pjesë e fushëveprimeve dhe prioriteteve.

GJUHA SHQIPE E HUMBUR NË PËRKTHIM

Faqja e internetit e Komunës së Ulqinit është platformë trigjuhësore (në gjuhën shqipe, malazeze dhe angleze), ku publikohen informatat të cilat kanë të bëjnë me aktivitetet dhe punën e kësaj vetëqeverisjeje lokale. Në gjuhën angleze janë të publikuara vetëm informatat që kanë të bëjnë me qytetin e Ulqinit dhe administratën e tij, ndërsa faqet në gjuhën shqipe dhe malazeze posedojnë aktualitetet dhe informatat me rëndësi për qytetarët e kësaj Komune, publikimi i të cilave parashihet në **Ligjin për Qasje të Lirë në Informata**. Temë e kësaj analize është, në mes tjerash, krahasimi i përmbajtjes së faqes së internetit të Komunës së Ulqinit, në gjuhën shqipe dhe malazeze, të cilat janë në përdorim zyrtar në këtë vetëqeverisje lokale.

Faqja e Internetit e Komunës së Ulqinit ka shtatë kategori kryesore, të cilët janë të njëjta në të dy gjuhët: AKTUALITETE, KRYETARI I KOMUNËS, KUVENDI I KOMUNËS, QEVERISJA LOKALE, SHËRBIMI PËR QYTETARË, PËR ULQININ dhe INFO.

Në kuadër të kategorisë **"AKTUALITETE"** kryesisht janë të publikuara informatat për ngjarjet dhe aktivitetet në të cilët marrin pjesë funksionarët publik të Komunës. Përmbajtja e kësaj kategorie është e ngjashme në gjuhën shqipe dhe malazeze: prej më 1 janar deri me 24 shtator të vitit 2019, në gjuhën shqipe janë publikuar **64** aktualitete, ndërsa në gjuhën malazeze dy më shumë, përkatësisht **66**.

Nëse krahasojmë kategorinë **"KRYETARI I KOMUNËS"**, vërehet se në të dy gjuhët janë publikuar biografite dhe përshkrimi i punëve të anëtarëve të kabinetit, informata që kanë karakter të përgjithshëm. Mirëpo informatat më specifike, siç janë vendimet dhe marrëveshjet, janë publikuar vetëm në gjuhën malazeze. Shembull që veçohet është **seksioni VENDIMET DHE MARRËVESHJET i cili në gjuhën shqipe është krejtësisht bosh, ndërsa në faqen e internetit në gjuhën malazeze është i plotësuar me gjithsej 315 marrëveshje dhe 12 vendime. Vendimi për zgjedhjen e kryetarit të Komunës së Ulqinit** është po ashtu shembull interesant, i cili u publikua vetëm në versionin e faqes në gjuhën malazeze, megjithëse dokumenti është dygjuhësh.

VENDIMET DHE MARRËVESHJET

KABINET PREDSDJEDNIKA: ODLUKE I UGOVORI



Kabinet Predsjednika: Ugovori



SEE LIST OF ALL FILES



Kabinet Predsjednika: Odluke
Downloads: 12

Situata është e ngjashme edhe në kuadër të kategorisë **"KUVENDI I KOMUNËS"**. Informatat e përgjithshme të cilat përfshijnë biografite, përshkrimin e punëve dhe kompetencave, si dhe listën e këshilltarëve dhe anëtarëve të trupave punues janë të publikuara në të dy gjuhët. Këto informata, përveç që kanë karakter të përgjithshëm, ato janë edhe të përhershme, gjegjësisht pak ose aspak ndryshohen gjatë kohëzgjatjes së mandatit. Po ashtu, rendi i ditës për seancat e Kuvendit të Komunës së Ulqinit është publikuar në gjuhën shqipe dhe atë malazeze, veçanërisht prej formimit të përbërjes së re të Parlamentit Lokal. Përfundim bënë rendi i ditës nga Mbledhja e Tretë e Seancës së Parë të Rregullt, e cila u mbajt më 25 korrik të vitit 2018, i cili nuk u publikua në gjuhën shqipe. Vendimet të cilat janë miratuar në Parlamentin e Ulqinit prej fillimit të përbërjes aktuale e deri më 13 gusht të vitit 2018, janë publikuar në të dy gjuhët, përveç Vendimit për Zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit të Komunës së Ulqinit, i cili u publikua në faqen e internetit në gjuhën shqipe, por dokumenti është hartuar në gjuhën malazeze. Vendimet të cilat janë miratuar prej më 13 gusht të vitit 2018 e deri në fund të të njëjtit vit (gjithsej 32), janë publikuar vetëm në versionin e faqes në gjuhën malazeze, derisa gjatë vitit 2019 në gjuhën malazeze janë publikuar 32 vendime të miratuara, ndërsa 22 në gjuhën shqipe.

Vendim për zgjedhjen e kryetarit të Kuvendit Komunes së Ulqinit

Na osnovu člana 45. Zakona o lokalnoj samoupravi ("Službeni list Crne Gore -"br.02/18) , i člana 67 Statuta Opštine Ulcinj ("Službeni list Crne Gore -"opštinski propisi"br.16/11)Skupština opštine Ulcinj, na sjednici održanoj dana: 25.04.2018.god. donijela je

O D L U K U

O IZBORU PREDSJEDNIKA SKUPŠTINE

Në kategorinë „**QEVERISJA LOKALE**“ janë të vendosur seksionet të cilat përfshijnë informatat e përgjithshme për sekretariatet, shërbimet dhe zyrat të cilat funksionojnë në kuadër të Komunës së Ulqinit. Këto informata të përgjithshme përfshijnë biografitë personale të drejtuesve të organeve, si dhe përshkrimin e punëve e të kompetencave të organeve përkatëse dhe janë të publikuara në të dy gjuhët. Në kuadër të kategorisë „**SHËRBIMI PËR QYTETARË**“ një nga seksionet është edhe „**Kërkesa dhe formularë**“, ku duhet të jenë të vendosur formularët të cilët qytetarët i përdorin në mënyrë të përditshme gjatë kryerjes së punëve që janë kompetencë e vetëqeverisjes lokale. Mirëpo, qytetarët të cilët dëshirojnë t'i përdorin formularët në gjuhën shqipe, e të njëjtit t'i shkarkojnë nga faqja e internetit e Komunës së Ulqinit, pjesërisht kanë mundësi të bëjnë një gjë të tillë, pasi shumica e tyre janë vetëm në gjuhën malazeze. Më saktësisht, nga **73 kërkesa dhe formularë** të cilët janë të vendosur në faqen e internetit të Komunës së Ulqinit në gjuhën malazeze, vetëm **46 janë të vendosur në versionin e kësaj faqe në gjuhën shqipe**. Shembull shumë i mirë i këtij seksioni është Sekretariati për Ekonomi dhe Zhvillim, i cili nga **33 kërkesa dhe formularë** që përdoren për shërbimet që janë kompetencë e këtij dikasteri, **31 janë vendosur edhe në gjuhën shqipe**. Nga ana tjetër, si shembull të dobët mund të veçojmë Sekretariat për Planifikim Hapësinor dhe Zhvillim të Qëndrueshëm, i cili në faqen e internetit të Komunës së Ulqinit në gjuhën malazeze ka vendosur 10 formularë, ndërsa asnjë nuk është vendosur në faqen në gjuhën shqipe.

Sekretariati për Planifikim Hapësinor dhe Zhvillim të Qëndrueshëm, në faqen e internetit të Komunës së Ulqinit ka vendosur 10 formularë në gjuhën malazeze, ndërsa asnjë në gjuhën shqipe.

Në kuadër të të njëjtës kategori ekziston seksioni i veçantë „**Qasja e lirë në informata**“. Asnjë dokument në kuadër të këtij seksioni, pra as Udhëzuesit për Qasje të Lirë në Informata, publikimi i të cilëve është i obligueshëm sipas Ligjit për Qasje të Lirë në Informata, nuk është publikuar në gjuhën shqipe. Madje, duke klikuar cilindo nga 14 Udhëzuesit për Qasje të Lirë në Informata, për çdo organ ose shërbim në kuadër të kësaj vetëqeverisjeje lokale, vizituesi me automatizëm transferohet në versionin në gjuhën malazeze të faqes së internetit të Komunës së Ulqinit. Me Ligjin për Qasje të Lirë në Informata është paraparë edhe publikimi i Listës së Zyrtarëve dhe Nëpunësve, me titujt e tyre përkatëse, e cila është publikuar në faqen e internetit të Komunës së Ulqinit, por vetëm në gjuhën malazeze.

Asnjë Udhëzues për Qasje të Lirë në Informata nuk është publikuar në gjuhën shqipe.

Po ashtu, **asnjë program pune** i organeve dhe shërbimeve të Komunës së Ulqinit nuk është publikuar në faqen e saj të internetit në gjuhën shqipe. Në të vërtetë, shumica e organeve dhe shërbimeve të Komunës së Ulqinit nuk e kanë publikuar programin e vet të punës as në gjuhën malazeze. Kuvendi i Komunës së Ulqinit (Programi i punës për tremujorin e IV të vitit 2018), Sekretariati për Buxhet dhe Financa (Programi i Punës për vitin 2018), Sekretariati për Administratë dhe Veprimtari Shoqërore (Programi i Punës për vitin 2018), Qendra për Sistem Informativ (Programi i Punës për vitin 2018 dhe 2019 dhe raporti i punës për vitin 2018) si dhe Shërbimi i Mbrojtjes dhe Shpëtimit (Programi i Punës për vitin 2019 dhe Raporti i Punës për vitin 2018), janë të vetmit organe/shërbime të Komunës së Ulqinit të cilët i kanë publikuar programet e punës, por vetëm në gjuhën malazeze.

PROGRAM RADA I IZVJEŠTAJ O RADU SKUPŠTINE OPŠTINE



Program rada Skupštine Opštine za IV kvartal 2018 godine.

Datum: 28. Novembar 2018. | Veličina: 0.99MB | Adobe PDF

Në kuadër të së njëjtës kategori, përmbajtja e seksioneve tjera, siç janë „**Pyesni Komunën**“, „**Denonco Korrupsionin**“ dhe „**Anketa**“ është publikuar në të dy gjuhët. Po ashtu, „**Kërkesa për lëshimin e çertifikatës nga regjistri i të kurorëzuarve**“, përveç që është publikuar në të dy gjuhët, ka edhe opsionin e përzgjedhjes së gjuhës së shkarkimit të dokumentit, gjegjësisht llojin e çertifikatës, ku përveç gjuhës malazeze është shënuar edhe gjuha shqipe.

Dy kategoritë e fundit, „**PËR ULQININ**“ dhe „**INFO**“, kanë përmbajtje të njëjtë dhe informatat janë të publikuara në gjuhën shqipe dhe atë malazeze.

„**DOKUMENTE**“ është një nga kategoritë e veçanta në kuadër të faqes së internetit të Komunës së Ulqinit. Brenda seksionit „**Dokumentet e fundit**“, prej fillimit të vitit 2018 e deri më 24 shtator të vitit 2019 u vendosën 217 dokumente të ndryshme në gjuhën malazeze. Njëkohësisht, në faqen e internetit në gjuhën shqipe u vendosën 60 dokumente, prej të cilëve 10 nuk janë të përkthyer, respektivisht të njëjtit janë vendosur në gjuhën malazeze. Të gjithë këto dokumente janë vendime nga kompetencat e vetëqeverisjes lokale, të miratuar në mbledhjet e Kuvendit të Komunës së Ulqinit.

Në kuadër të seksionit „Dokumentet e fundit“, prej fillimit të vitit 2018 e deri më 24 shtator të vitit 2019, janë vendosur 217 dokumente në gjuhën malazeze dhe vetëm 50 në gjuhën shqipe.

„**Planet dhe programi i Komunës së Ulqinit**“ është seksioni i radhës brenda të njëjtës kategori. Planit Strategjik i Zhvillimit të Komunës së Ulqinit 2016 – 2020 me të gjithë aktet përcjellëse, Drafti i Planit Lokal të Veprimit për Luftë kundër Korrupsionit 2014 – 2020, Planit Lokal i Aktiviteteve për Arritjen e Barazisë Gjinore, Programi i Rregullimit Hapësinor i Komunës së Ulqinit, Programi i Objekteve të Përkohshme i Komunës së Ulqinit 2019 – 2023, si dhe Planet e Integritetit të Komunës së Ulqinit nga viti 2016 dhe 2018, janë vendosur në kuadër të seksionit të përmendur në faqen e internetit të Komunës së Ulqinit në gjuhën malazeze. Nga ana tjetër, në kuadër të së njëjtës kategori, në faqen në gjuhën shqipe, është vendosur **vetëm Planit i Integritetit i Komunës së Ulqinit, por edhe ai është i hartuar në gjuhën malazeze.**

Në kuadër të seksionit „**Shqyrtimet publike dhe publikimet**“, gjatë vitit 2018 dhe në nëntë muajt e parë të vitit 2019, në faqen e internetit të Komunës së Ulqinit në gjuhën malazeze janë publikuar **34** thirrje publike, derisa në kuadër të të njëjtit seksion në faqen në gjuhën shqipe janë vendosur vetëm **20** thirrje me karakter të njëjtë. Mirëpo, përveç titujve dhe njoftimeve për mbajtjen e shqyrtimeve publike, të cilët u publikuan në gjuhën shqipe, 9 draft-vendime (për të cilët u organizuan shqyrtimet publike) janë hartuar në gjuhën malazeze.

Në të njëjtën periudhë, brenda seksionit „**Prokurimet publike**“, janë publikuar gjithsej 57 njoftime për prokurime publike në faqen e internetit të Komunës së Ulqinit në gjuhën malazeze, ndërsa në versionin

PROKURIMET PUBLIKE



13. Mars 2017.

NJOFIM PER PROKURIME PUBLIKE: NDËRTIMI I ROTONDOS TEK KOMUNA –FAZA E PARE E SHETITORES NENE TEREZA

Po ashtu, në kuadër të të njëjtit seksion, në gjuhën malazeze janë vendosur edhe prokurimet publike të dy ndërmarrjeve publike themelues i të cilave është Kuvendi i Komunës së Ulqinit, konkretisht të NP për Kultivimin dhe Mbrojtjen e Egërsirave (dy njoftime) dhe NP Qendra për Kulturë (dy njoftime), por që nuk janë publikuar në faqen e internetit në gjuhën shqipe.

Emëruesi i përbashkët i seksioneve „Aktet e përgjithshme“, „Dokumentet e planifikimit hapësinor“, „Studimet dhe elaboratet“, „Legalizimi i ndërtimeve të paligjshme“ dhe „Dokumente: Arkitekti Kryesor i Qytetit“, në faqen e internetit të Komunës së Ulqinit në gjuhën shqipe është që: **nuk kanë dokumente në gjuhën shqipe, brenda tyre janë vendosur dokumentet në gjuhën malazeze ose (duke klikuar) vizitori në mënyrë të drejtpërdrejtë transferohet në faqen e internetit të Komunës së Ulqinit në gjuhën malazeze.**

Për shkak të rëndësisë të cilën për qytetarët kanë dokumentet që Komuna e Ulqinit publikon në faqen e vet të internetit, me këtë analizë dëshirojmë të veçojmë edhe seksionet „Shpalljet dhe konkurset“¹ dhe „Buxheti“². Njëzet shpallje dhe konkurse janë publikuar në gjuhën malazeze nga 1 janari i vitit 2018 e deri më 24 shtator 2019, e vetëm pesë në gjuhën shqipe. Në të njëjtën periudhë, në kuadër të seksionit „Buxheti“, në gjuhën malazeze janë publikuar buxhetet e kësaj vetëqeverisje lokale prej vitit 2014 deri në vitin 2019, derisa **në gjuhën shqipe nuk është publikuar asnjë dokument i këtij lloji**, gjegjësisht vizitori duke klikuar transferohet, me automatizëm, në faqen e internetit të Komunës së Ulqinit në gjuhën malazeze. Sa i përket buxhetit, vlen të përmendet fakti që Vetëqeverisja Lokale në vitin 2019 hartoi Udhëzuesin për Qytetar, i cili është dygjuhësh.

Asnjë buxhet i Komunës së Ulqinit nuk është publikuar në gjuhën shqipe.

Në pjesën e poshtme të faqes së internetit të Komunës së Ulqinit janë vendosur banerët, të cilët vizituesve iu lehtësojnë qasjen në dokumentet e kërkuara. Janë gjithsej 10 banerë, të cilët janë identik në gjuhën shqipe dhe atë malazeze: BUXHETI I KOMUNËS, STATUTI I KOMUNËS, QASJE NË INFORMATA, FORMULARË DHE KËRKESA, E-ADMINISTRATA, KOMISIONI ZGJEDHOR, ZGJEDHJET LOKALE 2018, ZGJEDHJET PRESIDENCIALE 2018, LEGALIZIMI I NDËRTIMEVE TË PALIGJSHME DHE ARKITEKTI KRYESOR I QYTETIT.

Prej dokumenteve të cilët nuk u përmendën në pjesën e deritashme të analizës, **Statuti i Komunës së Ulqinit është publikuar në të dy gjuhët, përkatësisht në gjuhën shqipe dhe atë malazeze. Po ashtu edhe Drafti i ri i Statutit të Komunës së Ulqinit u publikua në të dy gjuhët e përmendura.**

Përveç informatave dhe akteve në kuadër të banerit KOMISIONI ZGJEDHOR, të cilët u publikuan në të dy gjuhët, informatat dhe kartelat analitike nga Zgjedhjet Lokale dhe Presidenciale, të cilat u mbajtën në vitin 2018, janë publikuar vetëm në gjuhën malazeze.

VIZITA SEKRETE PËR TË DHËNAT PUBLIKE

Metodologjia e dytë e cila u shfrytëzua gjatë hartimit të kësaj analize ishte teknika e „Vizitorit sekret“³, e cila nënkuptoi vizitën anketuesve të trajnuar në sportelet e Komunës së Ulqinit, të cilët regjistruan dhe vlerësuan parametrat e ndryshëm të dygjuhësisë në ofrimin e shërbimeve publike nga Administratën Vendore. Identiteti i tyre nuk ishte i njohur për organin të cilin e hulumtuan, duke u prezantuar si shfrytëzues të zakonshëm të shërbimeve, gjë që atyre iu mundësoi që me besueshmëri të përshkruajnë ofrimin e këtyre shërbimeve. Synimi i hulumtimit ishte që të krijohet një pasqyrë më e qartë për nivelin e përfitimeve të shërbimeve administrative në gjuhën shqipe në Komunën e Ulqinit. Kjo fazë e hulumtimit përmbante disa skenarë të ndryshëm. Kërkesat e këtyre vizitorëve përfshinin punët më të shpeshta që janë kompetencë e Administratës Vendore, por edhe punët për të cilat me monitorimin e publikimit proaktiv të informatave në faqen e internetit të Komunës, nuk janë gjetur formularët dhe kërkesat në gjuhën shqipe.

1 <http://www.ul.gov.me/Komuna-e-Ulqinit/171/Shpalljet-dhe-konkurset.shtml> (vizituar më 24.09.2019)

2 <http://www.ul.gov.me/Komuna-e-Ulqinit/170/Buxheti.shtml> (vizituar më 24.09.2019)

3 Vizita sekrete në Byronë Qytetare të Komunës së Ulqinit në periudhën prej më 5 deri më 15 korrik 2019

Formularët në gjuhën shqipe të cilët “vizitorët sekret” kërkuar në Byronë Qytetare ishin:

- ✓ Kërkesa për ndihmë të njehershme financiare
- ✓ Kërkesa për lëshimin e librezës së punës
- ✓ Kërkesa për pagesën e kompensimit financiar për një fëmijë të porsalindur
- ✓ Kërkesa për llogaritjen e kompensimit për lokacionin e përkohshëm
- ✓ Kërkesa për lëshimin e vërtetimit për pagesën vjetore për shfrytëzimin e objekteve komerciale të cilëve iu mundësohet qasja nga rruga e Komunës
- ✓ Kërkesa për vërtetimin e Librit të Mysafirëve, Librit të Ankesave dhe Bllokut të Faturave
- ✓ Kërkesa për lëshimin e lejes për kryerjen e veprimtarisë hoteliere
- ✓ Kërkesa për lëshimin e lejes së ndërtimit
- ✓ Kërkesa për vendosjen e objektit të përkohshëm

Kërkesën për ndihmë të njehershme financiare, Kërkesën për lëshimin e librezës së punës dhe Kërkesën për pagesën e kompensimit për një fëmijë të porsalindur, formularët të cilët janë kompetencë e Sekretariatit për Administratë dhe Veprimtari Shoqërore, vizitorët i fituan vetëm në gjuhën malazeze.

Kërkesën për llogaritjen e kompensimit për lokacionin e përkohshëm, e cila është pjesë e kompetencave të Sekretariatit për Veprimtari Komunale dhe Mbrojtje të Ambientit, vizitorët e fituan vetëm në gjuhën malazeze, ndërsa Kërkesën për lëshimin e vërtetimit për pagesën vjetore për shfrytëzimin e objekteve komerciale të cilëve iu mundësohet qasja nga rruga e Komunës, e cila është kompetencë e të njëjtit sekretariat, ata e morën në formatin dygjuhësh.

Në formën e dokumentit dygjuhësh janë lëshuar edhe Kërkesa për vërtetimin e librit të mysa irëve, librit të ankesave dhe bllokut të faturave si dhe Kërkesa për lëshimin e lejes për kryerjen e veprimtarisë hoteliere, e të cilët janë pjesë e punës të cilën e mbulon Sekretariati për Ekonomi dhe Zhvillim.

Kërkesa për vendosjen e objekteve të përkohshme, me të gjithë formularët dhe vërtetimet përcjellëse, e që është kompetencë e Sekretariatit për Planifikim Hapësinor dhe Zhvillim të Qëndrueshëm, vizitorëve u janë dhënë në gjuhë shqipe dhe atë malazeze, gjegjësisht në format dygjuhësor. Mirëpo, e njëjta gjë nuk ngjau me Kërkesën për lëshimin e lejes ndërtimore, e cila është kompetencë e të njëjtit sekretariat, e cila me të gjithë formularët përcjellëse është dhënë vetëm në gjuhën malazeze.

DOKUMENTET NË GJUHËN SHQIPE VETËM ME KËRKESË PËR QASJE TË LIRË NË INFORMATA

Për dokumentet të cilët përmes monitorimit të publikimit proaktiv të informatave nuk i gjetëm në faqen e internetit të Komunës së Ulqinit, ndërsa me teknikën e „vizitorit sekret” nuk i arritëm t’i marrim nga zyrtarët dhe nëpunësit e Administratës Vendore, shfrytëzuam metodën e tretë të analizës, përkatësisht dërgimin e **kërkesave për qasje të lirë në informata**. Kjo metodologji nënkuptoi qasjen analitike të akteve, formularëve dhe dokumenteve të ndryshëm me qëllim vëzhgimin dhe përcaktimin e gjendjes faktike në fushën e përdorimit të gjuhës shqipe si gjuhë zyrtare në Komunën e Ulqinit.

Nga tre sekretariate të Komunës, Sekretariati për Planifikim Hapësinor dhe Zhvillim të Qëndrueshëm⁴, Sekretariati për Administratë dhe Veprimtari Shoqërore⁵ dhe Sekretariati për Veprimtari Komunale dhe Mbrojtje të Ambientit⁶ kemi kërkuar gjithsej 8 dokumente:

- ✓ Kërkesën për ndihmë të njehershme financiare
- ✓ Kërkesën për lëshimin e librezës së punës
- ✓ Kërkesën për pagesë të kompensimit financiar për një fëmijë të porsalindur
- ✓ Kërkesën për lëshimin e kushteve urbanistike – teknike
- ✓ Kërkesën për lëshimin e lejes së ndërtimit
- ✓ Kërkesën për përlogaritjen e pagesës për lokacionin e përkohshëm
- ✓ Kërkesën për përlogaritjen e kompensimit për rregullimin e tokës ndërtimore

4 Kërkesa nr. 05-1073/19 datë 24.09.2019

5 Kërkesa nr. 03-188/19 datë. 24.09.2019.

6 Kërkesa nr. 06-475/19 datë. 24.09.2019

Sekretariatet kompetente u përgjigjën brenda një afati shumë të shpejtë në të gjithë kërkesat tona, duke na i dorëzuar të gjithë informatat e kërkuara. Edhe pse këto dokumente nuk ishin të qasshme në faqen e internetit të Komunës së Ulqinit dhe në sportelet e Byrosë Qytetare gjatë procesit të monitorimit, ne megjithatë konstatuam se këto dokumente ekzistojnë në gjuhën shqipe në zyrat e Administratës Vendore.

Duke pasur parasysh përvojat e mëparshme gjatë shfrytëzimit të instrumentit për Qasje të Lirë në Informata, kësaj here mbetëm të kënaqur me reagimin e organeve të Komunës.

INTERVISTAT ME ZYRTARËT LOKALË: TA PËRMBYLLIM BISEDËN

Mali i Zi shpesh veçohet si shembull i demokracisë shumetnike dhe model i mirë për tërë rajonin tonë. Në shumë raste, ai merret si shembull për arritje pozitive, por jo edhe sa i përket realizimit të së drejtës për shfrytëzimin e gjuhës dhe shkrimit të popujve pakicë në administratë, edhe pse akti më i lartë juridik i këtij shteti e garanton një gjë të tillë.

Nëse në rastin konkret flasim për Komunën e Ulqinit, atëherë kjo dispozitë gjendet edhe në Statut, aktin më të lartë juridik të Komunës. Në veçanti për arsye se shqiptarët, sipas numërimit të fundit të popullsisë nga viti 2011, përbëjnë mbi 70 për qind të popullsisë së Ulqinit.

Hulumtimet dhe intervistat tona të realizuara me zyrtarë të Vetëqeverisjes Lokale tregojnë se **përdorimi i dygjuhësisë është i pamjaftueshëm, respektivisht në një masë të madhe ky parim kushtetues dhe ligjor nuk respektohet.**⁷

Kjo është e vështirë të kuptohet nëse dihet se gjatë gjithë kësaj periudhe të pluralizmit (gati tri dekada) pushtetin në këtë komunë e mbajtën partitë nacionale shqiptare. Në përbërjen aktuale të Parlamentit Lokal prej 30 këshilltarëve të cilët mbështesin dhe bëjnë pushtetin, 18 prej tyre janë nga radhët e partive dhe grupimeve nacionale shqiptare (*Forca e Re Demokratike, Koalicioni "Bashkë për të ardhmen e Ulqinit" dhe Unioni Demokratik i Shqiptarëve*).

Diçka e tillë është akoma më e pakuptueshme nëse dihet që gjuha është një nga elementet më të rëndësishëm të identitetit kombëtar të shqiptarëve në Mal të Zi dhe se pikërisht e "drejta e përdorimit të gjuhës" reflektohet në të gjithë të drejtat tjera të popujve pakicë.

Aq më tepër që me praktikën pozitive të respektimit të dygjuhësisë, Komuna e Ulqinit do të dërgonte edhe një mesazh të mirë në nivelin shtetëror. Sepse, nëse gjuhën e vet shqiptarët nuk e përdorin në vendet ku ata bëjnë shumicën absolute të popullsisë dhe ku përfaqësuesit e tyre politik janë pjesë e pushtetit vendor, me çfarë të drejte atëherë kërkojnë që të respektohet në nivelin shtetëror ose në vendet ku nuk përbëjnë shumicën e popullsisë.

Nëse tentohet të numërohen arsyet për situatën e tillë, atëherë ka shumë përgjigje. Këshilltari në Parlamentin lokal **Sabri Salaj** mendon se për Shqiptarët në Mal të Zi gjuha shqipe ende vazhdon të mbesë më shumë si një gjuhë e folur për popullin shqiptar në Mal të Zi sesa si një gjuhë e zyrtarizuar në institucionet lokale dhe shtetërore. *"Kjo vjen si shkak i mungesës së infrastrukturës administrative për institucionalizimin dhe standardizimin e saj në përdorim zyrtarë"*, është i bindur ai.

Zyrtari i Komunës **Milazim Mustafa** mendon se janë tri arsye përse gjuha malazeze mbizotëron në dokumentet zyrtarë të administratës lokale në Ulqin. *"Vetëcensura e zyrtarëve lokalë është e para. Pastaj, vendimet apo ankesat në vendime përfundojnë në gjykatë dhe aty duhet të përdoret gjuha malazeze, prandaj edhe në raste të caktuara jemi të detyruar që aktin ta hartojmë vetëm në gjuhën malazeze. Ndërsa arsyeja e tretë është se ligjet nuk janë të përkthyer në gjuhën shqipe, kurse vendimet lokale duhet t'i harmonizojmë sipas ligjeve"*, deklaroi ai.

Zyrtarja në pushtetin lokal **Teuta Mehmedoviq** pohoi se përdorimi i gjuhës malazeze është dominuese, veçanërisht gjatë hartimit të dokumenteve siç janë vendimet, kontratat, etj.

⁷ Intervistat e strukturuar janë zhvilluar në periudhën prej më 25.09.2019 deri më 30.09.2019

Edhe sekretari i Sekretariatit për Ekonomi dhe Zhvillim **Dr. Agron Ibrahim** thotë se *shqipja përdoret më pak për arsye se inspektoratet nga niveli shtetëror nuk i pranojnë shkresat apo aktvendimet në gjuhën shqipe, për arsye se ata nuk kanë njohuri të folurit e të lexuarit në gjuhën tonë.*

Kryeshefi i Shërbimit të Mbrojtjes dhe Shpëtimit **Saubih Mehmeti** thotë se nuk sheh ndonjë pengesë juridike ose praktike për përdorimin e gjuhës shqipe. *"Por, këtu mungon në rend të parë vullneti dhe përgatitja e zyrtarëve dhe nëpunësve në Administratën Lokale për përdorimin e gjuhës shqipe. Me përjashtim të disa organeve të Qeverisjes Vendore, gjegjësisht zyrtarëve, shumë pak aplikohet gjuha shqipe e kjo është për çdo kritikë, duke filluar nga unë personalisht. Për shkak të "kohës" në 20% të rasteve nuk e aplikoj shkrimin e gjuhës shqipe ose kur iu drejtohem organeve shtetërore",* tha ai.

Qëndrim të ngjashëm mbanë edhe këshilltari **Haxhi Sulejmani**. Ai është i bindur se *mungon vullneti që të përmirësohet përdorimi i gjuhës shqipe, në veçanti tek një pjesë e të punësuarve në Administratën Lokale dhe se për përdorimin e saj të pamjaftueshëm ndikon fakti që akoma nuk është formuar zyra për përkthime.*

Të gjithë pjesëmarrësit në këtë anketë të strukturuar pohojnë se funksionimi i një byroje ose shërbimi të veçantë për çështjet e përkthimit, do të përmirësonte dukshëm gjendjen. Mbetet dilemë vetëm në kuadër të cilit sekretariat do të vepronte ajo, apo duhet të jetë pjesë e Kabinetit të Kryetarit të Komunës.

Z. Salaj thotë se problemi themelor me të cilin ballafaqohet Komuna është *mungesa e kapaciteteve financiare dhe burimeve njerëzore për përkthim cilësor.* Edhe pjesëmarrësit tjerë theksojnë mungesën e përkthyesve profesionistë.

"Problemi ekziston vetëm në komunikimin ndërinstitucional. Problemi duhet të zgjidhet në ndryshimin e ligjeve në nivel shtetëror për njohjen e gjuhës shqipe si gjuhë zyrtare edhe në institucionet shtetërore", vlerëson z. Ibrahim.

Propozohet që të sigurohen kushtet në mënyrë që, në kuadër të punës, zyrtarët dhe nëpunësit lokal të ndjekin specializime shtesë në këtë fushë.

Disa pjesëmarrës, si z. Sulejmani, mendojnë që *normat për përdorimin e gjuhës duhet të jenë obliguese dhe si të tilla të bëhen pjesë e Statutit të Komunës.* Ai shton se duhet të vendosen edhe masat dënuese për përdorimin e pabarabartë të gjuhës shqipe në të gjithë nivelet.

Nga ana tjetër, zyrtari **Muhamet Nika** është i bindur që Kuvendi i Komunës duhet të shpërblejë në mënyrë simbolike të gjithë ato që përdorin dygjuhësinë në mënyrë të rregullt. Si praktikë të mirë të zbatimit të dygjuhësisë në territorin e kësaj komune ai veçon Shtëpinë e Shëndetit në Ulqin dhe objektin e kompanisë „Voli“ nga Podgorica.

Pra, në tregëti dhe në veprimtaritë shërbyese e kanë kuptuar që njohja dhe përdorimi i gjuhës së vendit është përparësi. Besojmë se kjo mund të „matet“ edhe me fitimin e realizuar.

Kështu duhet të jetë edhe në organet dhe institucionet lokale dhe shtetërore. Në veçanti në Ulqin, në të cilin shumica e qytetarëve janë shqiptarë. Njohja e njëkohshme si e gjuhës shqipes, ashtu edhe të asaj malazeze (serbe, boshnjake e kroate) lehtëson dhe avancojnë komunikimin ndëretnik e ndërkulturor në këtë mjedis.

NË VEND TË PËRFUNDIMIT

Përdorimi i gjuhës shqipe në administratën lokale në Ulqin duhet të jetë shembull në nivel të tërë shtetit. Mirëpo, ky hulumtim ka treguar se nuk është kështu.

Qeverisja vendore në Ulqin dhe të punësuarit e saj duhet të respektojnë normat kushtetuese dhe ligjore, respektivisht gjuhën e shumicës së popullsisë në këtë komunë, në mënyrë që qytetarëve shqiptarë t'u mundësohet qasje e shpejtë dhe e thjeshtë në informata në gjuhën e tyre amtare.

Komuna e Ulqinit vetëm pjesërisht publikon në gjuhën shqipe, në faqen e vet të internetit, informatat me rëndësi publike. Edhe pse publikimi i tyre proaktiv është i obligueshëm, kjo vetëqeverisje lokale zbaton në mënyrë të pamjaftueshme këtë parim të rëndësishëm në punën e administratës publike.

Dokumentet dhe formularët në gjuhën shqipe, të cilët janë pothuajse më të përdorshmit në realizimin e të drejtave të qytetarëve, nuk gjenden as në faqen e internetit të Komunës së Ulqinit e as në sportelet e Byrosë për Qytetarë. Edhe pse këto dokumente ekzistojnë të përkthyer dhe mund të merren direkt në zyrat e shërbimeve përkatëse, kjo është e pamjaftueshme për krijimin e një administrate të orientuar drejt qytetarëve dhe biznesit, por edhe për zbatimin e dispozitave ligjore të cilat garantojnë qasjen në informata e sidomos informimin e popullatës në gjuhën e vet amtare.

Gjithashtu është e pamjaftueshme që në gjuhën shqipe të përgatitet vetëm "Udhëzuesi për Qytetarë i Buxhetit" i cili publikohet gjatë procesit të diskutimit publik. Qytetarët në çdo kohë duhet të kenë akses në dokumentin e plotë të Buxhetit të Komunës, pasi kjo ndihmon dukshëm në rritjen e transparencës, llogaridhënies dhe përgjegjshmërisë në harxhimin e parasë publike.

Mospublikimi i të gjithë vendimeve të miratuara edhe në gjuhën shqipe, e paraprakisht edhe të drafteve të tyre, ngushton pjesëmarrjen e numrit më të madh të qytetarëve në vendimmarrje dhe përfshirjen e tyre në krijimin e politikave publike të rëndësishme për komunitetin lokal.

Sipas vëzhgimit tonë disavjeçarë, por edhe sipas vlerësimit të punonjësve dhe zyrtarëve të Qeverisjes Vendore, problemi i mospërdorimit të gjuhës shqipe në hartimin e dokumenteve zyrtare si dhe mospublikimi i tyre në faqen e internetit të Komunës së Ulqinit, është rezultat i mungesës së një zyre të veçantë, të specializuar, e cila do të merrej vetëm me punët e përkthimit, redaktimit dhe përshtatjes për publikim e për përdorim zyrtar të dokumenteve në gjuhën shqipe.

Sidoqoftë, duhet të ekzistojë më shumë dëshirë, dije dhe gatishmëri, por edhe të veprohet në mënyrë proaktive për zbatimin dhe realizimin e normave kushtetuese dhe ligjore kur bëhet fjalë për përdorimin zyrtar të gjuhës shqipe.



HORIZONTI I RI (HR) u regjistrua më 6 shtator 1999 me seli në Ulqin, menjëherë pasi Mali i Zi miratoi Ligjin e parë për Organizatat Joqeveritare.

Organizata jonë, gjatë dy dekadave, ka vepruar në mënyrë aktive për forcimin e demokracisë lokale dhe zhvillimin e shoqërisë civile në një komunitet të vogël e specifik.

Horizonti i Ri angazhohet për një ndikim më të madh të qytetarëve e veçanërisht të të rinjve, në proceset e vendimmarrjes në nivelin lokal. Njohuritë dhe përvojën tonë e ndajmë me të tjerët dhe vazhdimisht përqafojmë risitë në procesin e ndërtimit të një shoqërie civile të përgjegjshme.

Vizioni jonë është *një komunitet aktiv, qytetarët e të cilit kanë një ndjenjë të zhvilluar të respektit, përkatësisë dhe solidaritetit reciprok dhe të cilët angazhohen për të mirën e përbashkët.*

Projektet e OJQ-së "Horizonti i Ri" kanë për qëllim inkurajimin e të rinjve për të marrë pjesë në procesin e hartimit të politikave publike lokale, forcimin e dialogut ndërkulturor dhe marrjen e përgjegjësisë për planifikimin dhe zhvillimin e komunitetit.

Organizata jonë përpiqet të krijojë breza të suksesshëm të liderëve rinorë, por mbi të gjitha, qytetarë të ndërgjegjshëm e të përgjegjshëm të shoqërisë sonë.

HR ndërton me sukses partneritete dhe realizon projekte edhe në fushën e monitorimit të punës së administratës publike, transparencës dhe përgjegjshmërisë në shpenzimin e fondeve publike, si dhe nxitjen e zbatimit të Reformës së Administratës Publike në nivelin lokal.

Për 20 vite punë aktive, Horizonti i Ri ka arritur të ndërtojë imazhin e një OJQ-je të suksesshme në komunitetin lokal. HR vazhdimisht ka qenë një vendtakim për OJQ-të lokale dhe ka shërbyer si pikë referimi për vizitat e përfaqësuesve të organizatave të tjera nga Mali i Zi dhe rajoni. Horizonti i Ri ka disa vite që luan rolin e Qendrës Lokale të Resurseve për OJQ-të lokale, por gjithashtu shërben edhe si një urë e mirë lidhëse midis autoriteteve vendore e institucioneve shtetërore me organizatat lokale të shoqërisë civile.



NEW HORIZON
Civil Society Organization

OJQ "Horizonti i Ri"
rr. Kodre pn, 85360 Ulqin
E-mail: horizon@t-com.me
www.ngo-horizonti.org
 [newhorizonngo](https://www.facebook.com/newhorizonngo)